



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr. 1365/11

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Zenel Leku, në çështjen kontestimore të paditësit V.V nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N. H., avokat nga P., kundër të paditurës W. R.-B., M. F. me seli në P., të cilën e përfaqësojnë sipas autorizimit A. Sh. dhe L. B., jurist, lidhur me anulimin e vendimit mbi shkëputjen e kontratës së punës, në seancën e shqyrtimit kryesore datë 05.09.2013, në prani të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit V.V nga M., **ANULOHEN** si jo i ligjshëm Vendimi nr.01/2011 datë 01.06.2011, me të cilin paditësit i është shkëputur kontrata e punës datë 03.05.2011.

II. DETYROHET e paditura që paditësin ta kthej në vendin e mëparshëm të punës ku ka punuar të e paditura sipas kontratës së punës datë 03.05.2011.

III DETYROHET e paditura W. R.-B. me seli në P. që paditësit t'ia kompensoj të gjitha pagat mujore për periudhën kohore nga data 01.06.2011 e deri më dt.31.05.2013, në pagën neto, në shumën e përgjithshme prej 13.310.32€, për kontributin pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në shumën prej 749.82€ dhe tatimin në pagë që duhet të paguhet në Buxhetin e Kosovës në shumën prej 914.06€, ndërsa për periudhën e ardhshme nga data 01.06.2013 e deri në kthimin e tij në punë t'ia paguaj pagën mujore në shumën prej 556.45€, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 465 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi në padi, në seancat gjyqësore të mbajtura në këtë gjykatë, për mes të autorizuarit të tij, ka theksuar se e paditura me vendimin nr.01/2011 datë 01.06.2011, kinse për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave të punës, në mënyrë të njëanshme ja ka shkëputur kontratën e punës të lidhur me datën 03.05.2011.

Ka konsideruar se vendimi mbi shkëputjen e kontratës para skadimit është i kundërligjshëm dhe ska bazë ligjore për sjelljen e tij. Nuk qendrojnë pretendimet e palës së paditur si shkase në bazë të të cilave i është shkëputur kontrata e punës, pasi që, paraprakishtë në bazë të performancës së punës së tij, nga ana e të paditurës theksohet se paditësi i ka kryer punët gjatë punës provuese me sukses dhe në bazë të kësaj edhe i është vazhdu kontrata e punës. Nga performanca e përmbledhur e theksuar më lartë, prej gjitha pikave, është dalur konstatimi i përgjithshëm se paditësi me sukses i ka kryer punët dhe detyrat e punës, ka sjellje korrekte me kolegët e tij dhe mbi këtë bazë të njëjtë i është lëshuar kontrat me kohë të pacaktuar. Ka vlerësuar se për një periudhë tjetër prej 27 dite, prej momentit të vlerësimit, nuk ka mund të ndryshohet performanca e tij në aspektin negativ, aq më parë kur për këtë periudhë dhe nuk ka pas performancë nga ana e të paditurës për paditësin. Ka theksuar se në këtë rast, gjatë shkëputjes së kontratës së punës, kanë dominuar arsyet subjektive dhe se nuk

është zbatuar dispozita e nenit 70 e Ligjit të Punës së Kosovës, ku është përcaktuar mënyra e shkeputjes së kontratës në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë së precizuar dhe i ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit të provave të administruara të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që të njëjtit ti kryejnë obligimet që kanë të bëjnë me kompensimin e përcaktuar si nga raporti i ekspertizës financiare të datës 29.05.2013, të konstatohet si jo i ligjshëm vendimi mbi shkeputjen e kontratës dhe të njëjtit ti njihen të gjitha të drejtat nga puna që nga dita e largimit deri në ditën e kthimit në punë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për tri seanca të mbajtura 363,00€, për një seancë të shtyrë 60,00€, për precizimin e padisë 50,00€, në shumë të përgjithshme prej 473,00 €, për ekspertizë shumën prej 10,00 €si dhe taksën për padi dhe për aktgjykim sipas përcaktimit të gjykatës.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore përmes të autorizuarve të saj ka theksuar se paditësi e ka kaluar me sukses punën provuese por shkeputja e marrëdhënies së punës ka ardhur si rezultat i performancës jo të mirë pas kalimit të periudhës provuese dhe për shkak se puna e një institucioni mikro financiar kërkon përgjegjësi të lartë ku në vete ngërthen rrezikun financiar. Gjykata me rastin e vendosjes duhet të merr për bazë Raportin e performancës sidomos pjesën e katërt të raportit i cili në mënyrë deklarative thotë se “V.V duhet të fokusohet në uljen e PAR, me ndihmën edhe të Departamentit të mbledhjes, duhet të fokusohet në rritjen e numrit të klientëve, PAR duhet të jetë për zyrën e Mitrovicës në standardet e Institucionit, si dhe kërkohet zgjerim në regjion dhe mbajtje të raporteve të mira me koleg”. Pas këtij raporti z.V.V ka pasur takime me Menaxhmentin e Institucionit i cili ka menduar se është e arsyeshme ti ofrohet kontrata e punës në kohë të pacaktuar, për shkak se ka pas bindjen se z.V. do të punoj në përmirësimin e mangësive të gjetura në raportin e performancës për të cilin u fol më lartë. Pasi që është lidh kontrata për kohë të pacaktuar, nuk është bërë ndonjë raport për tu vlerësuar performanca e paditësit, mirëpo është marrë vendim që ti shkeputet kontrata e punës për arsyet e paraqitura në vendimin për shkeputjen e kontratës së punës. Ka theksuar se dëmi që i është shkaktuar kompanis nga paditësi e kalon pesë fishin e kërkuar për kompensim dhe mbi bazën e arsyeve të paraqitura ka kërkuar nga gjykata që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit sit të pabazuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykatë me dt.05.09.2013, bëri administrimin e provave si kontrata e punës e datës 03.05.2011, vendimi për shkeputjen e kontratës së punës V.nr.01/2011 datës 01.06.2011, ankesa kundër këtij vendimi e datës 06.06.2011, vlerësimi i performancës për paditësin nga data 01.03.2010 deri me datën 01.03.2011, raporti i portfolies së paditësit për periudhën sa ka qenë i punësuar te e paditura, ekspertiza financiare e datës 29.05.2013 dhe shqimi në manualin për punëtorin prill 2011.

Pas analizimit të provave secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe bindjes se lirë, në mbështetje të nenit 8 të LPK-së, gjykata erdhi në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsyet vijuese:

Gjykata paraprakisht e vlerësoi se paditësi konform dispozitave ligjore nga nenet 78 dhe 79 të Ligjit të punës i ka plotësuar kushtet ligjore për të iniciuar kontest pune në këtë gjykatë.

Ashtu siç kanë deklaruar përfaqësuesi të paditurës në përgjigje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore dhe provat e administruara rezulton që paditësi të ketë qenë në marrëdhënie pune të e paditura edhe më herët ku e paditura ka bërë raport për ta vlerësuar performancën për punën që e ka bërë (vlerësimi i performances së paditësit për periudhën nga data 01.03.2010 deri me datën 01.03.2011) dhe pas këtij vlerësimi paditësit i ka afruar kontratë për të themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në pozitën Agjend kreditor. Këtë kontratë palët kontraktuese e kanë nënshkruar me datën 03.05.2011.

Pa kaluar një muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate e paditura ka nxjerr vendim, nr.01/2011 datë 01.06.2011, me të cilin paditësit ja ka shkëputur kontratën e punës nga data 01.06.2009 dhe atë me arsyetim të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, uljen e shitjes, zvogëlimin e portofolios, rritjen e PAR-it, mungesën e përkushtimit drejtë një drejtimi pozitiv për organizatën dhe mos aftësia në plotësimin e detyrave të përcaktuar me kontratë. Nga shkresat e lëndës rezulton që, pas raportit të bërë nga e paditura për vlerësimin e performancës së paditësit për periudhën nga data 01.03.2010 e deri me datën 01.03.2011, e paditura ka lidh kontratë pune në kohë të pacaktuar me paditësin datë 03.05.2011 dhe ashtu siç e kanë pranuar të autorizuarit e të paditurës në seancën përgatitore të datës 14.05.2013 ndaj paditësit nuk është bërë ndonjë raport për ta vlerësuar performancën e tij por vetëm është vendosur që ti shkëputet kontrata e punës dhe atë sipas nenit 70 pika 1.4.2 të Ligjit të Punës.

Baza ligjore.

Me nenin 70 të Ligjit të Punës, nr.03/L-212, është parapa që: *“punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur: sipas pikës 1.4. punëdhënësi mund t’ia ndërprejë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes dhe atë sipas pikës 1.4.2 për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës. Me nenin 71 të po këtij Ligji është paraparë koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës dhe sipas pikës 1 “punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës me kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70 të këtij Ligji, dhe atë sipas pikës 1.1 për 6 muaj deri në 2 vite punësim, 30 ditë kalendarike”.*

Vlerësimet e gjykatës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Nga dispozitat ligjore të paraqitura më lartë, gjykata vlerëson se paditësit në kundërshtim me këto dispozita i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga fakti se e paditura me asgjë nuk ka provuar arsyet e paraqitura në vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, aq më tepër kur e paditura pasi ka vlerësuar performancën e paditësit ka vendosur që me të të lidh kontratë pune në kohë të pacaktuar dhe pa kaluar një muaj nga lidhja e kontratës, pa vlerësim të performancës, bien vendim me të cilin e ndërprejë marrëdhënien e punës. Nëse e paditura paditësin e ka vlerësuar paraprakisht dhe pas vlerësimit i ka ofruar kontratë në kohë të pacaktuar, atëherë shtrohet çështja se ku janë mbështetur arsyet për shkëputjen e kontratës së punës. E paditura nuk e ka respektuar as kohen e përcaktuar me ligj për shkëputjen e kontratës së punës në kohë të pacaktuar e cila periudhë në rastin e paditësit ka qenë 30 ditë para ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Në këtë rast e paditura ka vepruar edhe në kundërshtim me aktin e saj të brendshëm Manual për Punëtorin 2011, me të cilin në nenin 4.7 është parapa periudha njoftuese për përfundimin e kontratës së punës dhe se sipas pikës 3 të këtij neni punëdhënësi mund ta përfundojë një kontratë punësimi të përcaktuar më njoftim paraprak prej 30 ditësh.

Meqenëse paditësit në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartshënuara i është ndërprerë marrëdhënia e punës, gjykata e detyroj të paditurën që paditësin ta kthej në vendin e mëparshëm të punës ku ka punuar të e paditura sipas kontratës së punës datë 03.05.2011, të lidhur në kohë të pacaktuar.

Lidhur me kërkesën për kompensimin e të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës.

I autorizuari i paditësit me parashtresën e datës 19.07.2013 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj pagat për periudhën kontestuese prej 01.06.2011 deri me 31.05.2013, dhe atë neto pagën në shumë prej 13.310.32 €, për kontributin pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional shumë prej 749.82 € dhe tatimin në pagë që duhet paguar në dobi të Buxhetit të Kosovës 914,06€, ndërsa duke filluar prej 01.06.2013 pagën ujore neto prej 556,45€, deri me kthimin e tij në punë, më së largu deri me dt.05 te muajit vijues, për muajin paraprak.

Gjykata e ka aprovuar kërkesën e paditësit dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensoj të gjitha pagat mujore për periudhën kohore nga data 01.06.2011 e deri më dt.31.05.2013, në pagën neto, në shumën e përgjithshme prej 13.310.32€, për kontributin pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në shumën prej 749.82€ dhe tatimin në pagë që duhet të paguhet në Buxhetin e Kosovës në shumën prej 914.06€, ndërsa për periudhën e ardhshme nga data 01.06.2013 e deri në kthimin e tij në punë t'ia paguaj pagën mujore në shumën prej 556.45€.

Lidhur me vlerësimin e lartësisë së pagave të pakompensuara të paditësit të e paditura, gjykata e bazoj në ekspertizën me shkrim të dt.29.05.2013 të përgatitur nga ekspertja gjyqësor, sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, e cila ka nxjerrë përfundim se për periudhën prej pushimit të paditësit nga puna me datë 01.06.2011 e deri më dt.31.05.2013, paditësi të e paditura kishte me realizuar pagën neto në shumën e përgjithshme prej 13,319.32€, kontributin pensional që duhet paguar në Trustin pensional në emër të paditësit në shumën prej 749.82€ si dhe tatimin për paga që duhet të paguhet në buxhetin e Kosovës në shumën prej 914.06€

Ekspertizën e lartpërmendur gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe i'a dha besimin e plotë, këtë nga se ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e lartësisë së kërkesëpadisë në këtë çështje kontestimore.

Bazë për kompensimin e dëmit për cenimin e të drejtës së punëtorit në rastin konkret paraqet përgjegjësia e të paditurit në çështjen e paditësit, pasi që është vërtetuar se ajo paditësin në mënyrë të kundërligjshme e ka lënë jashtë marrëdhënies së punës, duke i pamundësuar kështu që të punoj dhe realizoj të ardhura.

Si rezultat i kësaj gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit lidhur me kompensimin e pagave është e bazuar dhe si të tillë aprovon në mbështetje të nenit 55 të Ligjit të Punës (Ligji nr.03/L-212) që e rregullon çështjen e të drejtës së punësuarit në pagë, kompensim të pagës dhe të ardhura të tjera dhe lidhur me nenin 154 të LMD-së, duke e detyruar të paditurin që paditësit t'ia kompensoj pagat e pa papaguara.

Gjykata gjatë vendosjes i vlerësoj edhe të dhënat e parashtruara nga të autorizuarit e të paditurës por të njëjtat nuk ishin bindëse që të vendoset ndryshe, meqenëse me asnjë prove nuk u argumentua ligjshmëria e ndërprerjes së marrëdhënie së punës së paditësit të e paditura.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u bazuan në dispozitat e neneve 449 dhe 452.1 të LPK-se, si dhe në tarifën e avokateve të Kosovës ashtu që është obliguar e paditura t'ia paguaj të autorizuarit të paditësit për tri seanca gjyqësorë nga 12€, për ekspertizë financiare 100€, e në shumën e përgjithshme prej 460€.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
Cnr.1365/11 date 05.09.2013

Gjyqtari
Zenel Leku

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.